**KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT**

**Tiranë**

Të nderuar anëtarë,

Në zbatim të pikave 2 dhe 3, të nenit 19, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", po ju parashtrojmë dokumentin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për vitin 2020, miratuar me vendimin nr. 01 prot, datë 28.01.2021, të Mbledhjes së Grupit për Menaxhimin Strategjik.

Në zbatim të kërkesave ligjore, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ligjit nr. 88/2019 "Për Buxhetin e vitit 2020", udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka përgatitur Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për vitin 2020, sipas kësaj shkrese dhe dokumenteve bashkëlidhur.

Monitorimi është procesi i vlerësimit të performancës, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar. Në kuadër të menaxhimit financiar, monitorimi ka rëndësi të veçantë si një nga pesë komponentët më të rëndësishëm të kontrollit të brendshëm. Monitorimi për veprimtarinë institucionale të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për vitin 2020, është kryer në kuadër të një analize krahasimore plan-fakt sa i përket produkteve të përcaktuar dhe zërave të shpenzimeve, dhe planifikimit të buxhetit në PBA-në (2020-2022).

Në kërkesat buxhetore për vitin 2020, Kolegji i Posaçëm të Apelimit, ka përcaktuar si produkt kryesor në realizimin e objektivit, "Çështje të ankimuara/shqyrtuara" me një plan vjetor në masën 90 çështje. Gjatë periudhës janar - dhjetor 2020, Kolegji ka marrë në shqyrtim 63 çështje. Numri i çështjeve të ankimuara/ shqyrtuara në Kolegj është i lidhur me ndërprerjen e procesit gjyqësor për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e virusit COVID -19. Në kuadër të masave mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar prej tij, me vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr.6, datë 11.03.2020 është kufizuar veprimtaria e institucionit për periudhën mars - maj 2020.

Fondet buxhetore të akorduara nga buxheti i shtetit në zbatim të ligjit nr. 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, janë përcaktuar në vlerën 127,000 mijë lekë. Me VKM nr. 927, datë 25.11.2020, është akorduar një shtesë në buxhetin për shpenzime personeli në vlerën ***4 milionë lekë.*** Plani për periudhën 12/mujore është ***131.000 mijë lekë*** dhe realizimi ***126.915,05 mijë*** lekë ose ***96.9 %***. Shpenzimet buxhetore sipas artikujve kryesore, paraqiten në tabelën në vijim.

000/lekë

| Programi | Llogaria ekonomike | Emërtimi | Plani vjetor | Realizimi vjetor | % realizimit |
|---|---|---|---|---|---|
| 03340 | 6000000 | Paga | 104.300 | 104.273 | 99.9% |
| 03340 | 6010000 | Kontribute për sigurimet shoqërore, shëndetsore | 9.700 | 9.667 | 99.7% |
| 03340 | 6020000 | Mallra dhe shërbime | 15,000 | 12.121 | 80.8% |
| 03340 | 2310000 | Investime Kapitale | 2,000 | 854 | 42.7% |
| | | **Total** | **131,000** | **126.915** | **96.9%** |

### *I - Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)*

Buxheti i miratuar në zërin paga për vitin 2020, pas rialokimit të kryer në muajin korrik (shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 13875/2 prot., datë 27.07.2020) dhe buxhetit shtesë të miratuar në muajin nëntor (VKM nr. 927, datë 25.11.2020) është ***104.3 milionë lekë*** dhe përbën 79.6 % të buxhetit total vjetor. Realizimi i buxhetit në paga për periudhën janar - dhjetor 2020, është ***104.2 milionë*** lekë ose 99.9 %.

Kjo vlerë përfshin pagat e punonjësve të strukturës organike prej 43 (dyzet e tre) punonjës, të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 101, datë 04.10.2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit" dhe pagat për 4 (katër) punonjësit me kontratë të përkohshme pune.

Theksojmë se buxheti vjetor i miratuar për vitin 2020, ishte i pamjaftueshëm për kryerjen e pagesës shtesë për shkak të vështirësisë të këshilltarëve të Njësisë së Shërbimit Ligjor, në zbatim të nenit 29, të pikës 5 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

### *II - Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)*

Buxheti i miratuar në zërin paga për vitin 2020, pas rialokimit të kryer në muajin korrik (shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 13875/2 prot., datë 27.07.2020) dhe buxhetit shtesë të miratuar në muajin nëntor (VKM nr. 927, datë 25.11.2020) është ***9.7 milionë lekë*** dhe përbën 7.4 % të buxhetit total vjetor. Realizimi i buxhetit në sigurime shoqërore për periudhën janar- dhjetor 2020, është ***9.6 milionë lekë*** ose 99.7 %. Fondi për sigurimin është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit, dhe në përpjesëtim të drejtë me shpenzimet për paga, si rrjedhojë argumentet e mungesës të fondit të pagave vlejnë dhe për këtë zë.

### *III - Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime (llogaria ekonomike 602)*

Në këtë zë përfshihen një gamë e gjerë materialesh dhe shërbimesh të domosdoshme për mbështetjen e veprimtarisë institucionale. Buxheti i miratuar në zërin mallra dhe shërbime për vitin 2020, pas rialokimit të kryer në muajin korrik është ***15 milionë lekë***, dhe përbën 11.4 % të buxhetit total vjetor. Realizimi i buxhetit në shpenzime për mallra e shërbime për periudhën janar- dhjetor 2020, është ***12.1 milionë lekë*** ose 80.8 %.

Në mënyrë të detajuar shpenzimet për mallra dhe shërbime paraqiten në tabelën në vijim:

| *MALLRA DHE SHËRBIME TË TJERA* | **Realizimi janar - dhjetor 2020 (në lekë )** |
|---|---|
| Shpenzime për kancelari dhe letër | **537.600** |
| Materiale higjeno sanitare | **556.800** |
| Tonera për fotokopje | **1.380.456** |
| Pjesë këmbimi për fotokopje | **287.640** |
| Shpenzime për energji elektrike, furnizim me uje, shërbime postare | **1.730.926** |
| Shërbime telefonie | **434.569** |
| Dezinfektim i ambienteve të Kolegjit për COVID-19 dhe prodhim panele plexiglass | **398.248** |
| Publikim në media të njoftimeve për pozicione vakante | **374.400** |
| Karburant për automjetin dhe gjeneratorin | **213.892** |
| Shërbime transporti (parkim për automjetin e institucionit + lavash + mirëmbajtje) | **210.000** |
| Shpenzime kompensimi për zyrtarët e zgjedhur (shpenzime telefonie ) | **1.163.700** |
| Shpenzime për sigurimin e jetës, shëndetit dhe pasurisë për gjyqtarët | **3.606.000** |
| Shpenzime për licensa për pajisjen firewall, zoom meeting dhe office 365 | **559.090** |
| Mirëmbajtje e faqes zyrtare të internetit dhe sistemit video | **140.800** |
| Shpenzime te tjera | **527.157** |
| **TOTALI** | **12.121.278** |

Gjatë periudhës janar - dhjetor, Kolegji i Posaçëm i Apelimit në bashkëpunim me organin qëndror blerës, Autoritetin e Blerjeve te Përqendruara ka përmbyllur procedurat e prokurimit si më poshtë:

- "Kërkesë për Propozim-Shërbim", me objekt: "Sigurim i jetës, shëndetit dhe pasurisë për Gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", me operator ekonomik fitues bashkimin e shoqërive Sigal sh.a dhe Sicred Sh.a, në vlerën 3.6 milionë lekë.
- "Kërkesë për Propozim- Shërbim" marrëveshje kuadër me afat 36 muaj, me objekt "Blerje tonera për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit", me operatorin ekonomik fitues shoqërinë Marketing Distribution shpk, në vlerën totale 5.9 milionë lekë.

Janë kryer shpenzime për telefoninë celulare ku përfshihen prokurimi i shërbimit për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor dhe drejtuesve të administratës si dhe kompensimi i gjyqtarëve, sipas kuotës mujore, përcaktuar me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 1, datë 14.01.2020 në vlerën totale 1.6 milionë lekë.

Janë kryer shpenzime që lidhen me mirëmbajtjen e faqes zyrtare të internetit, sistemit video, pajisjeve fotokopje si dhe licenca për aktivizimin e pajisjes firewall dhe programit "Zoom meeting", office 365 me vlerë totale 986.873 lekë.

Janë shlyer detyrimet lidhur më shpenzimet për energji elektrike, furnizim me ujë, shpenzime postare (postim dokumentacioni, abonim në shtypin e shkruar) si dhe publikime në media të vendeve vakante në institucion (8 publikime) për një vlerë totale 2.1 milionë lekë.

Janë kryer shpenzime për automjetin e institucionit duke përfshirë pastrimin, vend parkimin, mirëmbajtjen dhe karburantin, me vlerë totale 423.892 lekë.

Janë plotësuar nevojat e institucionit për materiale dhe shërbime të nevojshme gjatë aktivitetit të përditshëm të institucionit ku përfshihen shpenzime për kancelari, letër A4, materiale pastrimi dhe shpenzimet që lidhen me masat e parandalimit të përhapjes së Covid-19, si: furnizime me maska, solucion dezinfektues, dezinfektim dhe ndarje e ambienteve të punës në zbatim të rregullores "Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së infeksionit Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", me vlerë totale 1.492.648 lekë.

Gjithashtu në realizimin e kësaj periudhe janë përfshirë shpenzime për materiale dhe shërbime të tjera të natyrave të ndryshme si furnizimi me ujë të pijshëm, medikamente për ndihmën e shpejtë, taksa lokale, materiale elektrike/hidraulike, etj për një vlerë totale 527.157 lekë.

Diferenca në realizimin e fondeve të parashikuara lidhet me fondet e kursyera si rezultat i procedurave te prokurimit apo fonde të tjera të papërdorura gjatë vitit që kryesisht lidhen me reduktimin e aktivitetit si pasojë e epidemisë Covid-19.

### *IV. Investime kapitale (431)*

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2020 në investime është ***2 milionë lekë*** dhe realizimi ***854 mijë*** lekë ose 42.7 %.

Këto fonde ishin parashikuar për kompletimin me pajisje e poste pune për shtesat e kërkuara në strukturën organike të Kolegjit si dhe vënien në funksion të ambienteve në katin e parë të godinës ku vijon të ushtrojë veprimtarinë shoqata e të përndjekurve antikomunistë të Shqipërisë.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 230, datë 26.04.2018, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës, aktualisht në përgjegjësi administrimi të Kuvendit të Republikës", ambientet ku aktualisht vijon aktivitetin Shoqata Antikomuniste e të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë, kanë kaluar në administrim të Ministrisë së Drejtësisë për nevoja të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe Institucionit të Komisionerit Publik. Deri në këtë moment nuk është bërë e mundur kalimi i këtyre ambjenteve me qëllim përshtatjen e tyre.

Gjatë vitit 2020, për plotësimin e nevojave për nevoja të institucionit janë prokuruar mobilie në vlerën 759 mijë lekë (zëvendesim të karrigeve të dëmtuara) si dhe pajisje elektronike në vlerën 94 mije lekë.

Sa më sipër, bashkëlidhur lutem gjeni formatet standarde për raportimin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për vitin 2020.

Duke ju falënderuar për vëmendjen.